KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 1510 PROT
DATE 14.6.19

# RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

## PER FONDET E PERFITUARA DHE SHPENZIMET E KRYERA

## NGA PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

## PER VITIN KALENDARIK 2018

## PERMBLEDHJE E LENDES:


- Raporti i Audituesit të Pavarur
- Shënime mbi Deklaratat Financiare

1. Të përgjithshme
2. Politikat operuese
3. Rregullat e vlerësimit
4. Të ardhurat
5. Shpenzimet
6. Likuiditetet
7. Ngjarje të mëvonshme

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**

Drejtuar: **Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve**

Rruga Ibrahim Rugova, nr 4, Tiranë

**Partisë Bashkimi Liberal Demokrat**

Bulv Zhan dark ,Nr 16,Tirane

Të nderuar zotërinj,

Bazuar në ligjin 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i RSH", i ndryshuar në zbatim të vendimit të KQZ 23 datë 27.04.2018, si dhe kontratën e shërbimit nr 911/1 datë 26.04.2019 të lidhur me këtë institucion, kemi audituar pasqyrat financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) bashkëlidhur për fondet e përfituara dhe shpenzuara nga Partia Liberal Demokrate e Shqipërisë, që do ti referohemi në vijim me inicialet BLD, për vitin kalendarik 2018.

**Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Përgjegjësia e pasqyrave financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) për fondet e përfituara dhe shpenzuara nga BLD gjatë vitit 2018 është përgjegjësi e drejtimit të saj.

**Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. (deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) Auditimin e kemi kryer në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, SNA 800 " Mbi angazhimet e Auditimit për qëllime të vecanta". Këto standarte kërkojnë që auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave, mbi bazën e testeve, të fakteve dhe dokumentave që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise). Ai përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të ndjekura, vlerësimet e bëra

nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së fondeve të arkëtuara dhe shpenzuara për vitin 2018.

Ne cmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë mbi pasqyrat financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) për fondet e përfituara dhe shpenzuara nga BLD për vitin 2018.

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se, përvec shënimit 6/a, Pasqyrat Financiare(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) të BLD, gjatë vitit kalendarik 2018, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë.

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Rajmonda Reveli

**SHENIME TE AUDITUESIT TE PAVARUR MBI DEKLARIMET FINANCIARE TE PARTISE Bashkimi Liberal Demokrat, GJATE VITIT KALENDARIK 2018.**

**1. Të përgjithshme**

BLD është regjistrur me udhër të Ministrisë së Drejtësisë, dhe me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr 2122, datë 13.04.2005. President i saj është zoti Arjan Starova, partia operon me NIPT K72114451A.

**Organizimi dhe drejtimi:**

Organet e BLD janë:

- Kryetari i Partisë
- Kryesia e Partisë

**Burimet e financimit të Partisë janë:**

Burimet financiare të Partisë, me qëllim realizimin e synimeve politike e sociale, përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe financime të tjera private. Sipas ligjit për partitë politike, të gjitha financimet regjistrohen në një regjistër të posacëm, i cili administrohet nga krye-financieri i partisë.

**2. Politikat operuese**

Drejtimi i partisë, ka operuar për këtë periudhë që auditojmë në pajtim me ligjin 10019, datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar në ligjin 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe ligjin nr 9228 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'', i datës 29.04.2004 dhe në konformitet më aktet nënligjore, me objektin e veprimtarisë për të cilin është krijuar, dhe programit të caktuar nga organet qëndrore.

**3. Rregullat e vlerësimit**

**Mënyra e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Bazuar në auditimin e kryer, rezulton se të ardhurat janë evidentuar e deklaruar në bazë të arkëtimeve faktike, kontabiliteti është ndërtuar duke zbatuar parimin e kujdesit, ndërkohë që shpenzimet janë evidentuar e deklaruar në momentin e kryerjes së tyre.

**Monedha e raportuar**

Drejtimi Financiar i partisë ka përdorur si monedhë raportuese lekun. Fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera janë mbajtur bazuar në dokumentacionin fillestar në monedhat ALL . Pasqyrat(deklarata te arketimeve dhe pagesave te partise) janë përgatitur në lekë.

**Taksat dhe kontributet**

Partia është e përjashtuar nga taksat mbi fitimin. Ka pasur një të punësuar me detyre llogaritar arketar gjatë 2018 dhe ka paguar sigurime shoqerore shendetesore dhe pagen mbi pagen minimale 24.000lek ne muaj .

## 4. FONDET E PERFITUARA NGA BLD

| | | Monedha | | | Kursi | Total ne leke |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NR | Burimet e perfitimit | Leke | Ne lek | Ne natyre | | |
| 1 | Buxheti I shtetit | a | 0 | | | |
| 2 | Burime e veta | b | 0 | | | |
| 3 | Dhurimet | c | 310.000 | | | |
| 4 | Kredite | d | 0 | | | |
| 5 | Te tjera | e | 140.000 | | | |

4a. Buxheti i Shtetit

Nuk kishte fonde te dhena nga buxheti I shtetit per vitin 2018

4b. Burime të veta

Nuk kishte fonde nga burime te veta te partise per vitin 2018

4c. Dhurimet

Dhurimet kapnin vleren 310.000lek nga personat brenda partise te cilat jane te regjistruara ne Librin e Dhurimeve me vlera nga 30.000lek deri ne 95.000lek te gjitha te deklaruara me firmen e personit dhe nr e siguracionit qe ndodhet tek karta e identitetit.

4d. Kredite

Nuk kishte kredi te mara nga banka te nivelit te dyte ose persona private.

4.e Te tjera

Te tjera eshte fond I krijuar nga derdhja e kuatizacioneve ne rrethet Kurbin,Malesi e madhe .Lezhe,Diber dhe Kruje(bashkangjitur fotokopje librin e arkes per vitin 2018

**5. SHPENZIMET**

ne lek

| NR | Emertimi I shpenzimeve | Menyra e kryerjes se pageses | Shuma e fatures | Shpenzime te papaguara | Totali I shpenzimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shpenzime interneti, telefoni | Cash ne sportel | 16.073 | | 16.073 |
| 2 | Bashkia Tirane | Tek sporteli bashkise | 24.944 | | 24.944 |
| 3 | KQZ | | | | |
| 4 | Paga financiere | Cash nga arka | 207.648 | | 207.648 |
| 5 | OSHEE | Cash tek posta | 120.983 | | 120.983 |
| 6 | Shpenzime sigurimi | Cash banke | 80.352 | | 80.352 |
| | TOTALI | | 450.000 | | 450.000 |

Shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore detyrimisht duhen te paguan nga llog bankare e partise mbasi ato nuk njihen si shpenzime fiskale nese realizohen cash nga arka.

4

Ne pjesen e shpenzimeve duhet te pasqyrohesh dhe elementi shpenzime bankare per mbajtje llogarie 12muaj x300lek=3600lek

Nuk kishte pasqyra financiare me te 5 pasqyrat e saj si Pozicioni financiar,Performanca finaciare,pasqyra e kapitalit dhe Cash flow.Mu deklarua nga Zoti Halil Rama qe nuk kishin percjelle pasqyra financiare 2018 ne sistemin e tatimeve.Kontrollova dhe u mbeshteta tek pasqyra e arketimeve dhe pagesave te partise.

## 6. LIKUIDITETET

**Gjendje 31.12.2018**

| Pershkrimi | Monedha | Kursi | Vlera ne leke | Vlera ne euro | Totali ne leke |
|---|---|---|---|---|---|
| Arka | | | 0 | | 0 |
| Banka | | | 925.49 | | 925.49 |
| Totali | | | 925.49 | | 925.49 |

## 7. NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk kishte ngjarje te mevoneshme qe te mund te ndryshonin situaten e deklaruar.

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Rajmonda Reveli

## PYETËSOR UDHËZUES MBI GJETJET E EKSPERTEVË GJATË AUDITIMIT TË PARTISË PËR VITIN KALENDARIK 2018

1. Partia e audituar

Partia B. Liberal Demokrate e Shqipërisë

2. Kohëzgjatja e auditimit (data e fillimit dhe e mbarimit)

Auditimi zgjati 4 orë të plota data 9.06.2019

3. Vendi i kryerjes së auditimit

Zyra e ekspertes R. Kovaçi dhe zyra partisë BLD

4. Përfaqësuesi i Partisë Politike i përfshirë në auditim (Personi nga partia politike i cili i ka siguruar audituesit dokumentimin/evidencën e auditimit)

Përfaqësuesi i partisë ishte Helie Rama

5. Data dhe mënyra e njoftimit të parties për fillimin e auditimit

Data 23 Maj 2019

6. Data e marrjes së dokumentacionit/evidences së auditimit dhe mangësitë e evidentuara në marrjen e saj (nëse ka)

Data 8 Korrik 2019

7. Informacione të përgjithëshme (personi përgjegjës për kontabilitetin, personi përgjegjës për pranimin e donacioneve)

Nuk kishte person për specialist për financa kishte një llogaritar

8. Sa llogari bankare ka partia, a janë në përputhje me dispozitat ligjore?

Kishte llog bankare pranë Bankës BKT

9. Burimet e finacimit (në mënyrë të përmbledhur listoni burimet financiare dhe materiale, sa përqind nga kuatat e antarësisë, nga fondet publike, dhurimet, shërbimet, sponcorizimet ..etj.)

Burime financimi ishte 31 % nga kuotizacioni 69% nga dhurime e personave të partisë

10. A ka pas të ardhura monetare në para dhe a janë të regjistrura.

Të tjera si të ardhura vetëm kuota dhe donacion burimi partie

11. A është plotësuar deklarata e konfliktit të interestit në rastet e dhurimeve.

Po është plotësuar deklarata e konfliktit të interesit

12. A është zbatuar ligji mbi mënyrën e përfitimit të donacioneve (nësë ka marrë donacione nga subjektet e huaja apo private, nga burime të panjohura, nga organizatat publike, identifikimi I donatorëve dhe nësë ka kaluar kufiri maksimal I donacioneve) Identifikoni rastet e moszbatimit të ligjit.

Është zbatuar ligji për mënyrën e përfitimit të donacionit

13. Identifikoni donacionet që kanë kaluar kufirin dhe donacionet kumulative. (nëse një donator I vetëm ka dhuruar disa here duke e kaluar pragun)

Nuk ka pasur donacion që kalon kufirin.

14. A janë depozituar/arkëtuar të gjitha donacionet në llogarinë bankare specifike?

Donacioni i plotë depozitohet në emër e Partise

15. Mënyra e verifikimit të donacioneve në natyrë (identifikimi I donacionevengapartia)

Nuk ka pasur donacion në natyrë

16. A I ka pasqyruar partia politike të gjitha informacionet e kërkuara nga ligji:

(a) Deklaratat e konfliktit të interest nga dhuruesi

Po

(b) Raportet e Auditimit

Po

(c) Lista e dhurimeve

Po

(d) Shpenzimet e fushatës zgjedhore

| |
|---|
| Po |

(e) Dhënia e informacioneve shpjeguese për përdorimin e subvencioneve shtetërore.

| |
|---|
| Po |

17. Opinioni I auditimit (njësoj si në raportin e auditimit)

| |
|---|
| Sipas opinionit tonë, bazuar në analizimin e kryer në përputhje me standardet, shpjegimi [illegible] 6/a [illegible] e [illegible] BKS, [illegible] 2018 [illegible] |

Shënim: Ky lloj modeli do të përdoret nga audituesët për të dokumentuar gjetjet e tyre gjatë hartimit të raportit. Në vija të përgjithshme janë identifikuar fushat kryesore ku kërkohet një shpjegim më I detajuar nga audituesit. Ky pyetësor duhet të dorëzohet I plotësuar sëbashku me raportin e auditimit. E gjeni elektronikisht në faqen zyrtare të KQZ-s www.cec.org.al

[illegible]

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
RAIMONDA REVELI
NIPT: L 01529006 O
TIRANE
Nr. Cert. 87 Dt. 04.07.2012

| Nr | PASIVET AFATGJATA | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Huatw afatgjata | | |
| | > | | |
| 2 | Tw tjera afatgjata | | |
| | > | | |
| | | | |
| III | KAPITALI | | |
| | 1.Kapitali i pronnarit | | |
| | 2.Rezervat | | |
| | 3.Fitimi (Humba) e vitit financiar | | |
| | | | |
| | TOTALI I PASIVEVE | 0 | 0 |

## PASQYRA E TEARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 2018

(Bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës)

| Nr | Përshktimi i elementëve | Periudha raportuese 2018 | Periudha paraardhese 2017 |
|---|---|---|---|
| I | Të ARDHURAT | | |
| | Kuota të këshilltarëve të BLD | 140.000 | 123.000 |
| | Donacione nga veprimtare të BLD | 310.000 | 355.000 |
| | **T O T A L I   T ë   A R D H U R A** | **450.000 leke** | **478.000** |
| | | | |
| II | SHPENZIMET | | |
| | Pagesa të faturave të OSSHEE (dhjetor 2017-nëntor 2018 | 120.983 | 121.119 |
| | Taksë për infrastrukturën arsimore | 5.000 | 75.219 |
| | Tarifa e pastrimit | 10.000 | |
| | Taksa e ndërtesës | 9.944 | |
| 5 | Rroga vjetore e një punonjësi (sekretari-arshivë) | 207.648 | 200.438 |
| | Sigurime shoqërore e shëndetësore për 1 punonjës | 80.352 | 77.562 |
| | Telefoni celulare+kancelari | 16.073 | 3.662 |
| | **T O T A L I** | **450.000 leke** | **478.000** |

Financiere

Kimete Rama

SASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT — BLD — KRYESIA

Kryetari i BLD

Arian Starova

Nr. 17.89 prot
Dt. 28.03.2019

BLD BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

**Bashkimi Liberal Demokrat**
**Liberal Democratic Union of Albania**

Bul. "Zhan D'Ark", Nr. 16, Tiranë, Tel.: + 355 4 251 068
E-mail: arianstarova17@gmail.com

*Nr 28/3.Prot* *Tiranë, më 28.03.2019*

**Lënda:** **Dërgim Pasqyra Financiare**

**Për:** **KOMISIONIN QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

**T I R A N Ë**

Për sa ju përcjellim një kopje të Pasqyrave Financiare të Subjektit Bashkimi Liberal Demokrat me NIPT K72114451A për vitin 2018.

BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT – BLD – KRYESIA

**KRYETARI**

**Arian STAROVA**